Fjala e vënë në linjë e Christina Vasak me rastin e 14 korrikut 2020

(Tiranë, Rezidenca e Francës)

Zonja dhe zotërinj,

Të dashur persona që na ndiqni,

Bashkëkombës të dashur,

Ju uroj mirëseardhjen, juve që na ndiqni dhe na mbështesni në distancë.

Kush do ta kishte menduar një festim të tillë të 14 korrikut? Pandemia e COVID-19 është një realitet i trishtueshëm, i cili na është imponuar dhe që na detyron, kudo që të ndodhemi, të jemi të kujdesshëm dhe të dyfishojmë masat mbrojtëse. Kjo ka të bëjë me shëndetin e secilit prej nesh në kontekstin e një rritjeje, sipas vendeve, të numrit të të prekurve me koronavirus.

Më lejoni të përshëndes angazhimin e atyre që luftojnë kundër sëmundjes, guximin dhe forcën e karakterit, si dhe të shpreh solidaritetin e Francës me partnerët e saj në Shqipëri, në Evropë dhe më gjerë, të cilët janë prekur nga kjo krizë sanitare.

Siç e dini, solidariteti jonë me partnerët i tejkalon fjalët, edhe pse këto janë të rëndësishme, sepse shprehet me vepra në kuadrin e Bashkimit Evropian dhe të Kombeve të Bashkuara, pikërisht të Organizatës Botërore të Shëndetësisë, institucion ky i specializuar dhe kompetent.

Në Francë, më 14 korrik do të organizohet në Paris një ceremoni ushtarake për të dëshmuar unitetin dhe solidaritetin e një kombi të tërë, ndërsa më 11 nëntor do të organizohet edicioni i tretë i Forumit të Parisit mbi Paqen me temë kryesore "TË RINGRIHEMI DREJT NJË BOTE MË TË MIRË". Aty do të mblidhen të gjithë aktorët e qeverisjes botërore rreth zgjidhjeve konkrete dhe formave të reja të veprimit kolektiv për të rindërtuar, akoma dhe më mirë, duke u përpjekur të gjendet ekuilibri mes prodhimit dhe klimës, siç parashikonte Marrëveshja e Parisit e vitit 2015.

Do të diskutohet gjithashtu angazhimi i rinisë përmes shkollimit, formimit dhe punësimit. Ne punojnë këtu në këtë drejtim siç e dëshmon, pavarësisht nga pandemia, progresi i vazhdueshëm në bashkëpunimin universitar franko-shqiptar apo në fushën e urbanizmit dhe të administrimit të qëndrueshëm të territorit në Tiranë dhe Durrës, me ndihmën dhe mbështetjen e rajoneve të mëdha të Francës, siç janë Sud-Provence-Alpes-Côte d'Azur dhe Auvergne-Rhône-Alpes. Siç e kam përmendur më 14 korrik 2019, synimi ynë është të kontribuojmë për të mundësuar këtu në Shqipëri një të ardhme për të rinjtë shqiptarë. Një temë tjetër do të jetë marrja në dorë, për aq sa është e mundur, e drejtimit të fatit tonë të përbashkët në kontinentin tonë kryesisht.

Muajt e fundit kanë qenë të vështirë për Shqipërinë dhe popullin e saj për shkak të disa katastrofave të njëpasnjëshme, duke filluar nga tërmeti tragjik i 26 nëntorit 2019. Përveç ndihmës emergjente që sollën specialistët francezë të kërkim-shpëtimit, të nderuar me titull nga autoritetet

shqiptare, ne jemi kujdesur t'u përgjigjemi, falë shprehjes së vullnetit të mirë në Francë, kërkesave të ndryshme që paraqitën disa bashki apo organizata joqeveritare, me të cilat ne jemi lidhur dhe po punojmë. Për sa i përket pandemisë, ajo më nxiti të udhëtoj gjithandej në Shqipëri për të dhuruar, pas dallim apo preferenca politike, maska mbrojtëse, rreth 50 000 të tilla, të prodhuara në sajë të nismës humanitare të shoqërisë "Marlotex" në Berat, të presidentit dhe administratorit të saj të përgjithshëm Zotit Toska, kryetar i Klubit të Biznesit të Lionit "France-Albanie Business" (FAB), të drejtoreshës së përgjithshme zonja Qose dhe të gjithë personelit të kësaj ndërmarrjeje tekstile të dalluar.

Çfarë rreze tjetër drite pamë këto muaj? Do të përmendja tre gjëra duke filluar nga hyrja në fuqi më 19 qershor të Marrëveshjes ndërqeveritare mbi aktivitetin në Shqipëri të Agjencisë Franceze të Zhvillimit, vetëm katër muaj pas nënshkrimit të saj më 17 shkurt gjatë konferencës së donatorëve në Bruksel nga Kryeministri z. Rama dhe shefi i diplomacisë franceze z. Jean-Yves Le Drian. Pas negociatave në frymën e mirëkuptimit, dëshiroj të falënderoj të gjitha ata që dhanë kontributin e tyre në këtë sukses, qeverinë, Kuvendin dhe Presidencën e Republikës.

Shembulli i dytë: më 25 mars u morr vendimi aq i pritur për hapjen e negociatave të anëtarësimit në Bashkimin evropian për Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut. Pas rishikimit, projekti kuadër është në shqyrtim. Nëse flasim me fjalë të thjeshta, topi është në fushën shqiptare për të gjitha çështjet e mbetura, të cilat nuk janë pak.

Shembulli i tretë: përgjegjësitë e rritura të Shqipërisë në skenën ndërkombëtare, siç është kryesia e OSBE-së 2020. Në ndryshim nga shumë vende të tjera fqinje, dhe jo më pak të rëndësishme, Shqipëria bën përpjekje të mëdha të ndjekë në çdo pikë politikën e jashtme dhe të sigurisë së përbashkët, gjë që më besoni nuk është aspak e lehtë dhe shënon marrëdhëniet e saj me Bashkimin Evropian dhe Shtetet anëtare, në një kohë kur po rifillon, në sajë të z. Borrel, të Presidentit Macron dhe të Kancelares Merkel, dialogu mes Serbisë dhe Kosovës.

Një politikë e tillë është e mirëpritur në perspektivën e marrjes së përgjegjësive më të larta, pa precedent, në Këshillin e Sigurisë së Kombeve të Bashkuara si anëtare jo e përhershme.

Para se të përfundoj, dëshiroj të kujtoj dy data që fatkeqësisht janë harruar, dy përvjetorë. Nga njëra anë 70-vjetori i deklaratës së Robert Shumanit të 9 majit 1950, pa të cilën nuk do ishim ku jemi sot dhe Bashkimi Evropian nuk do të kishte këtë rëndësi, dhe nga ana tjetër 50-vjetori i Frankofonisë, lindur më 25 mars 1970 në Niamej. Këtë vit, "Pranvera e Frankofonisë" në Shqipëri kishte ambicie të mëdha, të denja për përmasat botërore të Frankofonisë. Partnerët tanë frankofonë, në Shqipëri dhe më tej, të cilëve u shpreh mirënjohjen time, kishin ndërmarrë pjesën e tyre, por pandemia na ndaloi në vrullin tonë kolektiv. Arritëm të paktën të organizonim një seminar të jashtëzakonshëm arkeologjik ndërkombëtar, me një mobilizim të gjerë në Shqipëri, Zvicër, Gjermani, Greqi, Itali, me Shkollat franceze të Athinës dhe të Romës, seminar që theksoi në mënyrë shkencore aktualitetin e trashëgimisë dhe potencialin e saj për zhvillimin e një turizmi të qëndrueshëm të fokusuar tek zhvillimi.

Rroftë Shqipëria, rroftë Tirana, gëzuar datëlindjen dhe jetë të gjatë kryeqytetit, rroftë Franca, rroftë Bashkimi Evropian (viel Erfolg wünschen der deutschen Ratspräsidentschaft!) dhe rrofshin Kombet e Bashkuara! Faleminderit!